RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës si dhe nenit 29 të Statutit të Radio Televizionit të Kosovës, Bordi i RTK-së shpall:

Thirrje e Hapur

Për zgjedhjen e pesë anëtarëve të Grupit Këshillues të Publikut

- Tre (3) anëtarë prej komunitetit shqiptarë
- Një (1) anëtarë prej komunitetit serb
- Një (1) anëtarë prej komunitetit tjerë jo-shumicë.

Prishtinë data 04.03.2022

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Përmbajtja

Hyrje 3
Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës dhe Organet drejtuese 3
Qëllimi 3
Objektivat 4
Kompetencat dhe përgjegjësit 4
Përbërja 4
Përzgjedhja 4
Pamundësia për të qenë anëtar i Grupit Këshillues të publikut 5
Paraqitja e Aplikacioneve 5
Afati për dorëzimin e Aplikacioneve 5

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Hyrje

Ligji është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 29.03.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL-012- 2012, më datë 12.04.2012.
Ligji është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr 7 /, më 27 Prill 2012 dhe ka hyrë në fuqi më 12 Maj 2012.

Neni 3 i Ligjit për RTK-në përcakton që Radiotelevizioni i Kosovës është Transmetues Publik i Kosovës, me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore. RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës dhe Organet drejtuese

Në bazë të Ligjit për RTK-në /Neni 4/ Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës.
Kuvendi i Republikës së Kosovës mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të Radiotelevizionit të Kosovës, të përcaktuar me këtë ligj.

Në bazë të Nenit 24 të Ligjit të RTK-së, organet drejtuese dhe udhëheqëse të RTK-së janë:
Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.
Bordi i RTK-së është organ kolegjial-drejtues i RTK-së dhe përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

Qëllimi

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) në kuadër të përgjegjësive që ka me Ligjin dhe Statutin e RTK-së emëron Grupin Këshillues të Publikut, që do të jetë një trup kolegjial. Grupi do të përbëhet prej (5) individëve profesionistë të fushës dhe do të merren me shqyrtimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të publikut në raport me programet që ofron mediumi publik.

Si rrjedhojë Bordi i RTK-së bën këtë thirrje të hapur publike për të ftuar individë me kredibilitet të lartë në shoqërinë kosovare dhe njohës të mirë të etikës dhe standardeve më të larta të gazetarisë, të aplikojnë për të qenë pjesë e Grupit Këshillues të Publikut që do të funksionojë në kuadër të Bordit. Anëtarët e Grupit nuk do të jenë të kontraktuar nga RTK-së, por do të funksionojnë si një mekanizëm i pavarur në mes të politikave programore të RTK-së dhe interesave të publikut.

Objektivat

Grupi Këshillues i Publikut do të punojë në realizimin e këtyre objektivave të përgjithshëm:

- Forcimi i rolit të publikut në raport me shërbimet që i ofron transmetuesi publik;
- Avancimin e politikave programore të transmetuesit publik në raport me publikun;

Brenda periudhës dy vjeçare anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut kanë për detyrë që të ndihmojnë Bordin e RTK-së në realizimin e këtyre objektivave të lartpërmendura duke u mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë si në vijim:

Kompetencat dhe përgjegjësitë

- Pranon vërejtjet dhe sugjerimet e publikut përsa i përket çështjeve të ndryshme të programeve të transmetuesit publik;
- Shqyrton dhe selekton vërejtjet dhe sugjerimet e publikut;
- E këshillon Bordin e RTK-së që të shqyrtohen çështjet e caktuara lidhur me programet e RTK-së;
- I rekomandon Bordit të RTK që të sigurojë se Drejtori i Përgjithshëm do të marrë masa në rast se vërejtjet dhe sugjerimet janë të bazuara në Ligjin e RTK-së, Statutin, Standardet profesionale dhe parimet etike gazetareske;
- Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut do të takohen të paktën katër herë në vit;
- Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut kanë të drejtë në kompenzim, të përcaktuar nga Bordi i RTK-së;
- Puna e Grupit Këshillues të Publikut duhet të jetë publike dhe qëndrimet dhe rekomandimet e tij do të jenë publike.

Përbërja

Në Grupin Këshillues të Publikut emërohen tre anëtarë/e nga komuniteti shumicë shqiptarë, një pjesëtar/e nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet tjera, të cilët/at janë të regjistruar si banorë të Kosovës dhe kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë. Anëtarët e tij duhet të jenë ekspertë në lëmin që është me rëndësi për punën e këtij Grupi Këshillues.

Përzgjedhja

- Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut emërohen nga Bordi i RTK-së në bazë të procedurave të hapura dhe transparente;
- Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut zgjidhen me mandat prej dy vitesh me mundësi të riemërimit;
- Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut nga radhët e veta emërojnë dhe shkarkojnë Kryesuesin;
- Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Grupit Këshillues të Publikut, Statuti, përgjegjësitë dhe çështjet tjera për ushtrimin e veprimtarisë përcaktohen me Statutin e RTK-së dhe me Rregulloren e punës së Bordit të RTK-së;
- Kryetari/ja i/e Bordit të RTK-së cakton një komision të veçantë i përbërë nga anëtarët e Bordit për vlerësimin e aplikacioneve.

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Pamundësia për të qenë anëtar i Grupit Këshillues të publikut

Anëtarë të Grupit Këshillues të Publikut nuk mund të bëhen personat të cilët nuk mund të bëhen anëtarë të Bordit të RTK-së, ashtu siç e parasheh Neni 27 I Ligjit për RTK-në si;

- anëtarët/et e familjes së ngushtë të stafit menaxhues;
- ish-punonjësit të punësuar në RTK në dy (2) vitet e fundit;
- personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionarët publikë) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
- është anëtar/e i/e organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
- është anëtar/e i/e organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike;
- ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;
- të mos jetë i/e dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
- pronarët apo bashkëpronaret e medieve transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;
- është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me Ligjin në fuqi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Paraqitja e Aplikacioneve

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në webfaqen e RTK-së www.rtklive.com. Formulari zyrtar i aplikimit duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet në vijim:

- Një kopje të CV-së;
- Një Letër motivuese;
- Një kopje e letërnjoftimit;
- Dëshmitë e kualifikimit;
- Dëshmi që nuk është nën hetime;
- Tri letra të referencës.

Afati për dorëzimin e Aplikacioneve

Dorëzimi i dokumentacionit të kompletuar për aplikim për anëtarë të Grupit Këshillues të RTK-së, mund të bëhet duke filluar nga data **04.03.2022** deri më **18.03.2022** , deri në orën 16:00.

Aplikacionet duhet të dorëzohen përmes postës elektronike ne e-maili adresës: yllkaasimi@rtklive.com

Pyetjet rreth procedurave dhe kushteve për aplikim, mund të parashtrohen përmes telefonit në: 038 242 273, mob: +383 43843838 dhe përmes e-mailit të cekur më lartë.